



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

Nr. _____ Prot.

Datë ____/____/2009

Vendim
Nr.133 datë 14.12. 2009

“Për disa rekomandime për Entin Rregullator të Energjisë në lidhje me aplikimin për tarifën e reja të energjisë elektrike për vitin 2010 nga KESH Sh.A, OST Sh.A dhe OSSH Sh.A”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar
Rezana	KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14/12/ 2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Dhënien e rekomandimeve për Entin Rregullator të Energjisë Elektrike lidhur me:
- Aplikimin e KESH Sh.a për çmimin e shitjes së energjisë elektrike të Furnizuesit Publik me Shumicë (KESH sh.a) për vitin 2010 dhe çmimin e shitjes së energjisë elektrike të KESH-Gen (KESH sha),
- Aplikimin e OST Sh.a për tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2010,
- Aplikimin e OSSH Sh.a për tarifën e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2010 nëpërmjet përdorimit të rrjetit të shpërndarjes,

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, germa f dhe neni 70, pika 2.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Dokumenteve të aplikimit për tarifën e reja të energjisë elektrike për vitin 2010, të paraqitura nga OSSH, OST dhe KESH dhe të publikuara nga ERE;
- Prezantimeve të paraqitura në tryezën e rrumbullakët të zhvilluar nga ERE me palët e interesura, më datë 25.11.2009;
- Relacionit të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike po shyrton aplikimet për çmimet e reja të energjisë elektrike për vitin 2010 dhe ka kërkuar opinionet e institucioneve mbi aplikimet e KESH Sh.A, OST Sh.A dhe OSSH Sh.A.

Autoriteti i Konkurrencës, në bazë të nenit 70 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” bashkëpunon me Entin Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike për të siguruar konkurrencë të ndershme dhe efektive në treg.

Të tre ndërmarrjet KESH Sh.A, OST Sh.A dhe OSSH Sh.A janë në pozicionin dominant(monopol) në tregjet përkatëse të prodhimit dhe furnizimit me shumicë, trasmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë dhe për këtë arsye, për shkak të shkallës së lartë të dominimit të tregjeve përkatëse, kanë përgjegjësi të veçanta të sjelljes në treg. Në bazë të praktikës dhe të të drejtës së konkurrencës, sa më e madhe të jetë dominanca në një treg përkatës(dhe në rastin konkret ndërmarrjet janë monopol), aq më të mëdha janë përgjegjësitë e veçanta ndaj konsumatorëve.

Llogaritja e tarifave për energji elektrike për vitin 2010 është bazuar në Deklaratën Rregullatore¹ për të tre operatorët KESH Sh.A, OSSH Sh.A dhe OST Sh.A. Për llogaritjen e tarifave të reja për vitin 2010 të tre shoqëritë bazohen në të ardhurat e parashikuara për tu realizuar në vitin 2010.

Bazuar në Deklaratën Rregullatore, në rast se kërkesa për të ardhura e OSSH-së në funksionin e saj si FPP për një vit të dhënë rezulton me një rritje të tarifës totale mesatare të ponderuar për konsumatorët tariforë më të lartë se 15 % në terma realë mbi CPI(indeksin e çmimeve të konsumit), *atëherë rritja minimale e tarifës mesatare të njohur nga ERE do të jetë 15 % në terma realë.*

Gjykimi i Autoritetit të Konkurrencës dhe rekomandimet përkatëse janë dhënë vetëm mbi bazën e të dhënave të disponueshme deri në marrjen e vendimit. Për një gjykim më të plotë dhe më objektiv, Enti Rregullator i Energjisë Elektrike dhe

¹ Deklarata Rregullatore miratuar nga ERE me vendimin nr. 12, datë 03.03.2009, e cila është e vlefshme deri në vitin 2014, pika 6

tre ndërmarrjet aplikante duhej të ishin më transparente dhe të kishin vënë në dispozicion informacione më të plota, më të sakta dhe në kohën e duhur.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa f dhe nenin 70, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

I. Tí rekomandojë ERE-së të sigurojë transparencën e nevojshme për Autoritetin e Konkurrencës, lidhur me informacione sa më të plota, më të sakta dhe në kohë, për të mundësuar një gjykim objektiv mbi sjelljen e operatorve me pozitë dominuese në tregjet përkatëse.

II. Ti rekomandojë Entit Regullator të Energjisë Elektrike që:

II.1. Lidhur me aplikimin e KESH Sh.A.:

- Tarifa e gjenerimit për vitin 2010 të jetë e orientuar drejt kostos së gjenerimit dhe normës së kthimit të kapitalit.
- Mbështetur në pikën 5.7, paragrafi i fundit të Modelit të Tregut të Energjisë, çdo fitim neto nga eksportet i KESH Sh.A i parashikuar për vitin 2010, duhet të kihet parasysh që të reflektohet në përfitim të klientëve tariforë.

II.2. Lidhur me aplikimin e OST Sh.A,

- Rritja e pritshme e tarifës së transmetimit të orientohen drejt kostos mesatare të ponderuar të trasmetimit të çdo kilovatorë energjie. Gjithashtu, mbështetur në Metodologjinë e Tarifave për OST-në, tarifat e këtij operatori të orientohen drejt kostos mesatare afatgjatë të sistemit të trasmetimit.

II.3. Lidhur me aplikimin e OSSH- Sh.A:

- Mbi propozimin e paraqitur në aplikimin e operatorit për heqjen e bllokut të parë të konsumit si një subvencion i fshehur për klientët familjarë, rekomandojmë që të rishikojë këtë propozim bazuar në parimin që tarifat duhet të motivojnë për përdorimin me eficensë të energjisë elektrike nga përdoruesi fundor.
- Mbi propozimin e OSSH-së për tarifën mesatare të ponderuar për konsumatorët tariforë, propozojmë që ERE të miratojë një tarifë në minimumin e lejueshëm nga Deklarata Rregullatore.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e Entit Rregullator të Energjisë elektrike brenda datës 15.12.2009.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)
Anëtar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)
Anëtar

Lindita MILO (LATI)

(_____)
Kryetar